



INSTITUTI I ÇËSHTJEVE KOMBËTARE

INSTITUTE OF NATIONAL AFFAIRS

Court Registration No. 106, date 27.12.2001

Address: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Hotel "DAJTI" Mexoline Nr1, Tirana -Albania,

Tel & Fax: + 355 4 251 051; Mob: 069 21 05 787, E-mail: instituteofnationalaffairs_al@yahoo.com

DEKLARATË

Instituti i Çështjeve Kombëtare prej vitesh ka ndjekur zhvillimet social-politike në Kosovë, si dhe dramën e madhe dhe të dhimbshme, pothuajse shekullore, të banorëve të saj, përballë represionit dhe genocidit të organizuar shtetëror serb, i cili fatmirësisht, përfundoi në favor të kosovarëve më 1999 me largimin e policisë dhe ushtrisë okupuese serbe; kjo falë ndërhyrjes vendimtare e të mirëprurit të trupave ushtarake të NATO-s, si dhe raportet rajonale dhe ndërkombëtare mbi këtë çështje.

Ne jemi të vetëdijshëm se rruga e gjatë dhe e vështirë që përballuan dhe kaluan shqiptarët e Kosovës për të arritur deri më sot dhe për të jetuar dhe gëzuar të lirë në trojet e tyre etnike nuk mund të realizohet pa ndihmën dhe mbështetjen e fuqishme të Komunitetit Ndërkombëtar me në krye qeverinë e SHBA-së, BE- së dhe organizmave të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

Instituti i Çështjeve Kombëtare si shprehës i aspiratave kombëtare të popullit të vet, konfirmon se shqiptari është mirënjohës dhe nuk i harron miqtë e tij, për gjithë atë çfarë kanë bërë për të, në ditët e tij të vështira dhe për të ardhmen e tij. Me këtë rast ne gjejmë mundësinë të falenderojmë dhe t'iu shprehim mirënjohjen tonë për gjithë institucionet ndërkombëtare, OKB, qeverinë Amerikane, Bashkimin Europian, NATO-n dhe mjaft organizata të tjera ndërkombëtare që i hapën rrugën pa kthim çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës.

Në këto momente kur pritet që të fillojnë diskutimet zyrtare për njohjen e Statusit të Kosovës ne ju drejtohem palëve të interesuara që të hyjnë në këto negociata dhe bisedime, të udhëhequr nga qëllimi i mirë për të zbatuar sa më drejt vullnetin e përcaktuar të popullit dhe klasës politike të Kosovës.

Ky proces i nisur nuk mund të lihet përgjysëm sepse në Kosovë tani, përveç rindërtimit të saj, është ngritur dhe infrastruktura institucionale si në nivelin lokal ashtu dhe në atë kombëtar. Populli i Kosovës në këto vite ka demonstruar botërisht vetëpërmbytje, urtësi politike, ka respektuar institucionet e UNMIK-ut dhe ka ditur të ndërtojë institucionet e tij, të dala nga zgjedhjet e ligjshme në Kosovë. Ai ka fituar, tashmë, një përvojë pozitive, atë të vetqeverisjes. Është bërë një përgatitje konceptuale dhe institucionale si etapë kalimtare për të kaluar në një fazë të re, që do t'i japë vendit mëvetësinë, institucionet dhe zhvillimin social-ekonomik të tij. Instituti gjen rastin të falenderojë Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili nëpërmjet konsulencës dhe administrimit të tij, i hapi rrugën krijimit dhe forcimit të institucioneve të Kosovës së pavarur.

Ne shprehim besimin tonë se zgjidhja përfundimtare e statusit të Kosovës duhet të bëhet plotësisht në përputhje me ligjet dhe aktet ndërkombëtare, respektimin e të drejtave të njeriut dhe parimet demokratike. Kosova nuk mund të copëtohet dhe zgjidhja duhet të sigurojë multietnicitet të qëndrueshëm të banorëve të saj, për ti shërbyer stabilitetit të mëtejshëm rajonal.

Instituti është i mendimit se edhe pas përcaktimit të statusit përfundimtar të saj, në Kosovë duhet të vazhdojnë të qëndrojnë edhe për disa vjet të tjerë prezenca ndërkombëtare civile dhe ushtarake për të ndihmuar në konsolidimin e mëtejshëm të institucioneve të brishta dhe ekonomisë vendase, si dhe në integrimin e saj të shpejtë në strukturat euro-atlantike.

Instituti i Çështjeve Kombëtare duke patur parasysh tërë kompleksitetin e kësaj çështje të veçantë dhe të vështirë, ka studiuar deklaratat dhe qëndrimet zyrtare të shumë personaliteteve dhe subjekteve ndërkombëtare, të interesuara për zgjidhjen përfundimtare të statusit të Kosovës. Në këtë kontekst Instituti ka zhvilluar sondazhe publike; e ka parë çështjen në frymën e akteve, konventave dhe ligjeve të së drejtës ndërkombëtare dhe deklaruar se opsioni i pavarësisë së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, është vendimi më i përshtatshëm, më i pranueshëm dhe përjashton çdo situatë konfliktuale të nesërme, duke kontribuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë politike të rajonit. Me pavarësinë e Kosovës, Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Tirana do të jenë nesër një element qëndror i ndërtimit të paqes dhe Europës së re, të bazuar mbi vlerat e Bashkimit European.

Tiranë më 24. 11. 2005

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kastriot FRASHËRI